
REPUBLIKA E SHQIPËRISË

PROCESVERBAL

Tipi i kontratës - Mall

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROCEDURËS:

“Blerje materiale hidraulike,tubo, pvc,pe,Corrogete ”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):
Materiale hidraulike 44115210-4

**VLERA E FONDIT LIMIT: 9 997 619 (nente milion e nenteqind e nentedhjet e shtate mije
e gjashteqind e nentembedhjetë) leke pa tvsh**

Argumentimi : mbeshëttur ne nenin 35 të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik” i ndryshuar
Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe
nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit
publik”, autoriteti/enti kontraktor **Shoqeria Rajonale Ujesjelles Kanalizime sh.a Pogradec** ka
hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve
për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

I. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. Sigurim oferte, sipas Shtojcës shtojca 4;*
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit shtojca 9*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, nenit 30, të VKM
nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.i ndryshuar

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë plotësohet me paraqitjen e Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit të operatorit ekonomik në ditën e hapjes së Ofertës, sipas Shtojcës 9.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".i ndryshuar

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për 3 vitet e fundit financiare 2022,2023,2024, vlera e xhiros minimale vjetore duhet të jete jo me e vogel se 3 999 047.6 (40%) te vleres se parashikuar te kontrates.Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë **arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar** nga autoriteti/enti kontraktor".

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Në zbatim të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", neni 43 "Vlera e xhiros së kërkuar në këtë lloj procedure nuk mund të tejkalojë 40 % të vlerës së përlogaritur të kontratës ose lotit, në procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar, dhe në kontratat e shërbimit me natyrë intelektuale, ku nuk mbizotërojnë aspektet fizike të veprimtarisë dhe që kërkojnë ekspertizë të posacme. Kërkesa për plotësimin e kapaciteteve financiare konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar nga autoriteti/enti kontraktor

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohet, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar në VKM "Për rregullat e prokurimit publik", e cila parashikon se Autoriteti koonraktor për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike mund të kërkojë për një periudhë maksimumi deri në 3 vitet e fundit financiare. Kjo është një kërkesë e cila nuk e pengon konkurrencën dhe është e bazuar në garancinë që ofertuesi i paraqet Autoritetit Kontraktor.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen afatet për paraqitjen nga tatimpaguesit të deklaratës vjetore pranë organeve tatimore).

2.2.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë bilancet vjetore, për 3 vitet e fundit financiare të certifikuar nga organet tatimore, ku bilancet e dy viteve të njëpasnjëshme, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, nenin 41, të ligjit Nr. 10 091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshur “**Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare**”, përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese.

(Shënim: citoni dispozitën përkatëse të legjislacionit tatimor, ku përcaktohen rastet kur personat juridikë kanë detyrimin që të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga eksperte kontabël ose shoqëri audituese).

2.2.3 Vërtetimi për shlyerjen e taksave dhe tarifave vendore të parashikuara nga Pushteti Vendor për vitin **2025**, prane njesive vendore ku operatori ekonomik ushtron apo ka ushtruar aktivitetin, sipas ekstraktit të QKB, në përputhje me legjislacionin në fuqi. Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomikë, çdo anëtar i grupit duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Autoriteti përkatës

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, në nenin 43, pika 6, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, në ligjin nr.9920 datë 19.05.2008 “Për procedurat tatimore” i ndryshuar, neni 4, pika 2, gërma d) dhe në Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” i ndryshuar. Referuar sa më sipër, Autoriteti Kontraktor gjykon se kriteri i vendosur lidhur me dorëzimin nga ana e operatorëve ekonomikë të deklaratës për shlyerjen e detyrimeve vendore për vitin 2025 sipas kësteve pranë bashkisë/ve ku operatori ekonomik ushtron aktivitetin e tij është në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi e konkretisht me Ligjin nr.9632, datë 30.10.2006 për “Sistemin e Taksave Vendore” I ndryshuar. Të gjithë subjektet që ushtrojnë veprimtari biznesi kanë detyrimin ligjor të regjistrimit pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit për të bërë të identifikueshëm vendodhjen e aktivitetit të tyre dhe për t’iu nënshtuar pagesës së taksave vendore të parashikuara shprehimisht në këtë ligj.

2.3.4 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, në një vlerë jo më të vogël se 3 999 047.6 40 % të vlerës së fondit të limit të kësaj kontrate.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Autoriteti/enti kontraktor si dëshmi për përvojën e mëparshme kërkon vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës ose/dhe fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

- b) Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, si dëshmi pranohen vetëm fatura tatimore të shitjes, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, dhe të deklaruara në organet tatimore, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që furnizimet e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 40 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufi të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme është vendosur në vlerën limit të kufirit të vlerës të përcaktuar në rregullat e prokurimit publik, duke qenë një kontratë e rëndësishme me mallra specifike të nevojshme për Shoqerine Rajonale Ujesjelles Kanalizime Sh.a për të treguar se ofertuesit me kapacitetet e tyre kanë realizuar kontrata të ngjashme me objektin që prokurohet në vlerën jo më të vogël se 40 % të fondit limit, në afat dhe me cilësi dhe rrit besueshmërinë mbi përvojën që ka ofertuesi në treg. Përvoja e ngjashme është një “kompetencë thelbësore”, ndaj operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmi të tilla si referenca/fatura tatimore, për ta provuar kryerjen e tyre qoftë me sektorin privat dhe atë publik.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

2.3.5 Deklarate e operatorit ekonomik i cili merr persiper transportin dhe levrimin e mallrave prane ambjenteve magazinuese te Autoritetit Kontraktore.

Argumentimi: Operatori ekonomik duhet te paraqese ne dokumentat e tenderit nje deklarate qe verteton faktin qe mallrat do ti sjelle prane AK , pra nepermjet kesaj deklarate AK i lind e drejta te kerkoje qe malli te vije prane Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime sh.a Pogradec , dhe jo ta transportoje AK ate.

2.3.6 OE ofertues duhet të paraqesë **Autorizim Prodhuesi** ose **distributor zyrtar** për mallrat objekt prokurimi. Në rast paraqitje të autorizimit nga distributori i autorizuar, operatori ekonomik duhet të provojë me dokument, lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Argumentim: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenit 40, pika 5, gërma a,) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”,

Autorizimi i prodhuesit ose nga distributor i autorizuar eshte kerkuar me qellim qe te konfirmoje statusin aktual te OE dhe te siguroje institucionin (AK) qe kompanite e duhura ofrojne mallrat

dhe shërbimet e kërkuara, pasi në treg mund të ketë tregëtarë që mund të blejnë nga të tretët dhe kjo nuk i bën të autorizuar për procedurën e prokurimit.

2.3.7 Operatori ekonomik duhet të paraqesë **Katalogun e prodhuesit** të mallrave, ku të vërtetojë përputhjen e plotë të mallrave që ofron me specifikimet teknike të kërkuara. Katalogu duhet të ketë të detajuar specifikimet teknike të mallrave që do të ofrohen, ku të vërtetohet që mallrat e ofruar, plotësojnë specifikimet teknike të kërkuara. **Pjesët e katalogut ku tregohen specifikimet teknike, të jenë të përkthyer në shqip dhe të noterizuara.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 e LPP, si dhe nenin 40, pikë 6/b të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. është gjykuar si kriter i domosdoshëm, pasi katalogu i mallit tregon karakteristikat teknike të produkteve, me qëllim përmbushje të të gjitha kërkesave dhe specifikimeve teknike.

2.3.8 Operatorët Ekonomik në momentin e hapjes së ofertave, duhet të paraqesin nga një mostër për të gjithë artikujt/zërat e preventivit.

Dorëzimi i mostrave, të bëhet pranë Shoqërisë Rajonale të Ujësjellës-Kanalizime Pogradec Sh.A.

Data e dorëzimit të mostrave të jetë data e hapjes së ofertave data 19.03.2026 deri në orën 12:00.

Mostrat e dorëzuara jashtë këtij afati, nuk do të pranohen nga AK.

Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në kuti. Mostra duhet të ketë emërtimin sipas listës, të ketë të shënuar dimensionin dhe presionin.

NR	EMERTIMI I MALLIT
3	Adaptor PP dn 40x1 1/4 pn16
10	Bashkues PP dn 40 pn 16
13	Bashkues (kompjng) dn 400 ME DHEMBE(NDALUES)
14	Bashkues Gize për tuba PE dhe PVC me unaza Bronxi Dn 160Pn 16
15	Bashkues Gize me Fllanxha (Vario) DN 100 mm Pn 16 me kënd 10grade
17	Brryl Bashkues PP dn 40 pn 16
23	TI PP dn 32 pn 16
26	TEE Gize DN 160*80*160 mm me dy anaza bronxi dhe Dalja e mesit me Fllanxhe pn 16
27	TEE Gize DN 160*160*160 mm me tre anet unaza bronxi pn 16
28	TEE Gize 90*90*90 me tre anet unaza bronxi pn 16
33	Mufta Bashkuese PP dn 63*75 pn 16
38	Tubo për 100 dn 25 pn 16
41	Tubo për 100 dn 40 pn 10
56	Tubo Korroget dn 200

63	Tubo PVC dn 140
67	Brryl PVC dn 140
75	Saraqineska Bronxi dn 1*1/4
79	Saracineske + Set me fllanxha dn 50
82	Reduksion Xingato 2*1
86	Tapa Plastike 1/2 Mashkull
90	Tapa Xingato 3/4
92	Zgjatues xingato 25* 3/4 Femer Mashkull 3CM
94	Fasheta (kavallota) PP dn 200*2 pn 16
97	Fasheta (kavallota) Gize dn 180 x 2
110	Fasheta Riparuese Inoks dn 400 pn 16
112	Fashete Elektrofuzive DN 110*1 me dalje Bronxi
116	Manikota Elektrofuzive dn 225 pn 16
118	Kaseta Metalike 30*40*10 trashesia 1mm
119	Puceta Plastike Matesash
121	Tubo pl ppr DN 32
122	Tubo pl ppr DN40
127	Manikota PI me ngjitje lisho DN50
134	Manikota plastike me fileto Meshkuj DN32x1
139	Hollandez xingato 2"
149	Fllanxhe Adaptor dn 250 Gize
152	Matesa mekanik + Buketona 1"
157	Prixhioner M 16
158	Gomina Plastike 3/4
160	Buketona 3/4
161	Elektroda Inoksi 2.5
162	Elektroda 3.2
165	Fllanxhe Metalike Dn 160 Pn 10 me 8 Vrima
167	Kapak Gize EN124 Fi 400

Mos-dorëzimi i mostrave në momentin e hapjes së ofertave ose mospërputhja e mallrave të ofruara me mostrat e paraqitura, është kusht për skualifikim. Nëse ka mungesa mostrash për artikuj të veçantë, atëherë oferta do të quhet jo e rregullt dhe rrjedhimisht do të skualifikohet.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6/a të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i

kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose

2.3.9 Operatori Ekonomik duhet të paraqesë certifikatë **DVGW / WRAS ose ekuivalente**, të aprovimit për përdorimin e ujit të pijshëm për të gjithë mallrat që kanë kontakt me ujin e pijshëm, të lëshuar nga një trup i certifikuar ndërkombëtar apo kombëtar i akredituar

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

Referuar faktit se në preventivin objekt prokurimi kërkohen mallra të cilat do kenë kontakt me të drejtpërdrejtë me ujin e pijshëm(furnizim jetik për qytetarin) kërkohet që cilësia të jetë e lartë e standarteve të kërkuara me qëllim mosndikimin e faktorëve të jashtëm në cilësinë e ujit.

2.3.10 Operatori ekonomik, për matesat e ujit duhet të paraqesë **Certifikatën MID ose ekuivalente** të vlefshme gjatë kohës së zhvillimit të procedurës së prokurimit.

Argumentimi:Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79 të ligjit nr.162/2020, datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në nenin 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

MID- është certifikatë e bazuar në Direktivën e Instrumenteve të Matjes e cila nenkupton Miratimin e tipit të matesit dhe Vleresimin e Sistemit të Kontrollit të Cilësisë së Prodhimit.Paisja me këtë certifikatë nenkupton që prodhuesi e ka të aprovuar tipin e matesit,dhe gjithashtu ka të vlerësuar sigurinë e cilësisë nga një trupë notifikuese e miratuar Europiane,në mënyrë periodike, dhe mund të vendosi në produkt MID,për të shmangur produktet me MID fallse apo të modifikuar).

2.3.11 Ofertuesi duhet të paraqesë dokumentin e titulluar **Ofertë Teknike** i paraqitur nga AK në formën e një table (pjesë e dokumentacionit të specifikimeve teknike), kërkesat e të cilit duhet të plotësohen rigorozisht nga Ofertuesi për të gjithë listën e artikujve që kërkohen. Dokumenti Ofertë Teknike duhet të përmbajë të dhënat si më poshtë:

Nr.i Artikullit	Emërtimi i Artikullit	Emri i kompanisë prodhuese	Emri i katalogut	Kodi i artikullit ose nr.i Faqes në katalog ose dok. e noterizuar	Shënim

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, datë 23.12.2020” Për Prokurimin Publik”, si dhe bazuar në VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” e ndryshuar.

Qëllimi i vendosjes të kriterit të sipërcituar ka të bëjë me faktin e orientimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në fazën e ofertimit të dokumentacionit teknik të paraqitur nga operatorët pjesëmarrës.

SPECIFIKIMET TEKNIKE

1.Rakorderite Polipropilen

Rakorderite sherbejne per bashkimin dhe pershtatjen e tubave ose rakorderive plastike me permasa te ndryshme. Trupi i rakorderive te jete material Polipropilen me rezistence mekanike te larte. Produktet duhet te jene te bombarduara me rreze ultraviolet ne menyre qe 8acter krijojne alga ose baktere. Gjithashtu keto rakorderi nuk duhet ne asnje menyre te krijojne mikroorganizma ne uje te pijshem. Siperfaqja e brendshme e produkteve duhet te jete homogjene dhe nuk duhet te jete poroze. Produktet nuk duhet te permbajne asnje tip substance qe ndryshojne shijen ose eren e ujit. Presioni i punes te jete 16 bar (ose me I larte). Ndryshimi ne 8acterial8d e produkteve te jete maksimumi ± 0.5 mm nga 8acterial8d e kerkuara nga AK.

Argumentimi:

Mbeshtetur ne nenin 36 te ligjit nr 162/2020 per prokurimin 8acter “Specifikimet teknike” kerkohet qe specifikimet te mos hartohen ne menyre qe te favorizojne nje prodhues te caktuar . Materialet e kerkuara, si “polipropilen” “rezistence mekanike “ “presioni 16 bar” jane standarte teknike qe lejojne shume operatore te marin pjese duke permbushur parimin e transparences dhe barazise. Nga ana teknike Rezistenca UV :Polipropileni natyral dekompozohet nga dielli . Bombardimi me reze ultra violet eshte e domosdoshme pasi rakorderite do te ekspozohen jashte . Higjiena: Kërkesa që sipërfaqja të jetë “homogjene dhe jo poroze” parandalon krijimin e biofilmit (filmit 8acterial), gjë që është jetike për ujin e pijshëm. Presioni 16 Bar: Ky është një standard i lartë (PN16), që tregon se këto rakorderi janë të destinuara për linja me presion, jo thjesht për shkarkime gravitacionale.

2.Tuba te brinjezuar (korroget)

Tubat e brinjezuar duhet te jene te strukturuar prej polietileni me densitet te larte. Duhet te jene te forte ne menyre qe te mos pesojne carje apo fryrje.Tubat e brinjezuar duhet te jene te prodhuar ne ate menyre qe bashkimi i tyre te behet sipas metodes nje manikote dhe 2 guarnicione.

Argumentimi: Mbeshtetur ne nenin 36 te ligjit nr 162/2020 per prokurimin publik “Specifikimet teknike” kerkohet qe specifikimet te mos hartohen ne menyre qe te favorizojne nje prodhues te caktuar. Tubat e Brinjezuar (Korroget):Materiali (HDPE): Përmendja e "polietilenit me densitet të lartë" siguron që tubi të ketë elasticitet por edhe rezistencë ndaj goditjeve.Struktura: Brinjëzimi shërben për të përballuar ngarkesat e dheut (shtypjen) pa u shtypur tubi, ndërsa pjesa

e brendshme duhet të jetë e lëmuar për të lehtësuar rrjedhjen. Metoda e Bashkimit: Kërkesa për "një manikotë dhe 2 guarnicione" është zgjidhja teknike standarde për të garantuar hermetizimin (mosrrjedhjen) e sistemit të kanalizimeve.

3.Bashkues (Kompj)

Bashkueset shërbejnë për të bashkuar ose lidhur tubo PE, PVC, gize, cemento, celiku, me fibra xhami etj.. ndërmjet tyre. Bashkueset duhet ofrojnë garanci dhe siguri të bashkimit të tubove me ane të elementeve të ndryshme shtese që kanë në sektorin e mberthimit dhe shtrengimit të tubove. Bashkueset duhet të ofrojnë një tolerancë midis dy anëve të bashkimit të tubove prej 8 gradesh ose më të lartë, pa krijuar asnjë problem. Gominat izoluese të bashkueses duhet të jenë EPDM për përdorim për uji të pijshëm. Bashkueset duhet të kenë presion pune 16 bar ose më të lartë. Permasat e bashkueseve universale përkatesisht sipas preventivit. Të dy krahet e bashkueses duhet të jenë me gomine.

Argumentimi: Mbeshtetur në nenin 36 të ligjit nr 162/2020 për prokurimin publik “Specifikimet teknike” kërkohej që specifikimet të mos hartohen në mënyrë që të favorizojnë një prodhues të caktuar. Parametrat si "toleranca 8 gradë", "presioni 16 bar" apo "fortësia 210 HB" janë kritere sasiore të matshme. Ligjërisht, kjo e bën procesin e vlerësimit objektiv dhe të ankimeshëm nëse një operator skualifikohet padrejtësisht.

Universaliteti: Fakti që shërbejnë për bashkimin e materialeve të ndryshme (PE, PVC, gize, çeliku, etj.) tregon se bëhet fjalë për Bashkues Universalë Adaptues. Kjo është teknikisht e rëndësishme në rrjetet e vjetra ku bëhen ndërhyrje dhe duhen lidhur tubacione të materialeve të ndryshme. Toleranca Këndore (8 Gradë): Kjo është një vlerë shumë e rëndësishme teknike. Lejon që tubat të mos jenë në vijë të drejtë perfekte, duke absorbuar lëvizjet e tokës apo kthesat e lehta pa pësuar rrjedhje. Gominat EPDM: Përdorimi i EPDM (Ethylene Propylene Diene Monomer) është standardi “premium” për ujin e pijshëm pasi nuk lëshon lëndë toksike dhe ka jetëgjatësi të lartë ndaj plakjes.

Nepermjet ketyre specifikimeve siguron që Autoriteti Kontraktor të marrë produkte jetëgjata dhe jo produkte ekonomike që dështojnë pas pak vitesh.

4.RAKORDERITE XINGATO

Keto rakorderi të shërbejnë për lidhjen dhe/ose degezimin e një tuboje ose rakorderie me ato tubo ose rakorderi të tjera me permasa të njëjta ose të ndryshme. Rakorderite duhet të jenë material xingato. Forca që ajo duhet t'i rezistojnë është minimalisht 35000 N/cm² pa u deformuar, dhe të kenë rezistencën **shkallë formimi të pakten 210 HB**. Rakorderite duhet të jenë të mbuluar me zink në sasi minimalisht 450gr/m². Shtresa e zinkut duhet të jetë minimumi 65µm. Presioni që duhet të durojnë të jetë **minimumi 25 bar** në temperaturën nga -20°C deri në 100 °C. Permasat e rakorderive përkatesisht sipas preventivit.

Argumentimi: Mbeshtetur në nenin 36 të ligjit nr 162/2020 për prokurimin publik “Specifikimet teknike” kërkohej që specifikimet të mos hartohen në mënyrë që të favorizojnë një prodhues të

caktuar .Ky është një lloj gize e temperuar (malleable iron) që ka rezistencë të lartë ndaj goditjeve dhe nuk është e thyeshme si giza e zakonshme. Mbrojtja ndaj Korrozionit (Xingatimi): Kërkesa për 450g/m² zink dhe trashësi minimale 65µm (mikron) është një specifikim i fortë. Kjo garanton që rakorderia nuk do të ndryshket për dekada, edhe në mjedise me lagështi të lartë.

Presioni dhe Temperatura: Kapaciteti për të mbajtur 25 bar në temperatura deri në 100°C e bën këtë produkt të përshtatshëm të mbajtur 25 bar në temperatura deri në 100°C e bën këtë produkt të përshtatshëm jo vetëm për ujë të ftohtë, por edhe për sisteme ngrohjeje apo industriale me presion të lartë.

Nepermjet ketyre specifikimeve siguron që Autoriteti Kontraktor të marrë produkte jetëgjata dhe jo produkte ekonomike që dështojnë pas pak vitesh.

5.Fasheta PP

Fashetat sherbejne per krijimin e daljeve te sigurta ose linjave te reja ne tubat PE-HD sipas kerkesave. Keto fasheta duhet te jene me rezistence mekanike te larte dhe trupi i tyre te jete material Polipropilen. Fashetat PP përveç se duhet te suportojne presionin **16 bar**.Ndryshimi ne dimensionet e produktevete të jetë **maksimumi ± 0.5 mm** nga dimensionet e kerkuara nga AK. Qe te moskrijojne alga ose baktere, produktet duhet te jene te bombarduara me rreze ultraviolet. Rakorderite duhet te kene nje siperfaqe te brendshme homogjene dhe nuk duhet te jete poroze. Shija dhe era e ujit duhet te mos ndryshoje ne menyre absolute, pra keto rakorderi nuk duhet te permbajne asnje tip substance qe mund te ndikojte ne to.Keto fasheta me kompresion duhet te jene me unaze perforcuese po ashtu te galvanizuar.

6.TUBOT HDPE

Tuba polietileni me dendësi të lartë. Tubat të kenë një koeficient sigurimi minimalisht 1.20. Materialet e përdorura për prodhimin e tubave të jene jo toksike dhe të mos ndikojnë në cilësinë e ujit (mos t'i 10eliev atij as erë as shije). Të jenë fleksibël dhe me rezistencë ndaj vibrimeve dhe goditjeve sizmike, për tu përshtatur me 10elieving e tokës.Të jenë rezistent ndaj rrezeve ultraviolet dhe ndaj temperaturave -25 derinë 55°C.Të kenë rezistencë të lartë ndaj gërryerjes dhe jetegjatesi te pakten 50 vjet.Pamja e jashtme: të kenë siperfaqe të lëmuar dhe pa dëmtime, prerja fundore e tubit duhet të jetë e pastër dhe në kënd të drejtë me qendrën e tubit.Permasat dhe presionet e punes se tubove perkatesisht sipas preventivit.

7.FASHETA RIPARUESE

Fashetat riparuese te jene inoks. Gomina te jete e ngjitur me fasheten e inoksit me ngjites te perforcuar me fibra xhami per te pasur jetegjatesi dhe qendrueshmeri ndaj temperaturave te larta dhe lageshtise gjate montimit. Goma e perdorur ne fasheten e inoksit duhet te jete cilesi shume e larte sepse ka kontakt te drejtperdrejt me ujin e pijshem prandaj ajo duhet te jete per perdorim per uji te pijshem dhe te duroje temperatura deri 150 °C. Te mund te instalohen edhe nen presion

pa pasur probleme(pjesa e daljes se filetuar te jete me tap qe mos te lejoj rrjedhjen e ujit deri ne momentin e deshiruar).

Argumentimi : Mbeshtetur ne nenin 36 te ligjit nr 162/2020 per prokurimin publik “Specifikimet teknike” kerkohet qe specifikimet te mos hartohen ne menyre qe te favorizojne nje prodhues te caktuar Specifikimet e paraqitura jane rigoroze dhe synojne jetegjatesine e rrjetit (mbi 50 vjet) dhe sigurine e ujit te pijshem.

Rezistenca ndaj Presionit dhe Dimensionet: Kërkesa prej 16 bar për fashetat PP është standardi i lartë për rrjetet kryesore dhe sekondare, duke siguruar që pikat e lidhjes të mos jenë "pika e dobët" e sistemit. Toleranca prej ± 0.5 mm garanton hermetizim perfekt me tubat PE-HD.

Siguria Higjienike: Përdorimi i rrezeve ultraviolett (bombardimi UV) për të parandaluar algat dhe bakteret, si dhe kërkesa që materialet të jenë jo-toksike (pa ndikim në shije dhe erë), janë në përputhje me standardet e mbrojtjes së shëndetit publik.

Qëndrueshmëria Fizike:

Tubat HDPE: Koeficienti i sigurisë 1.20 dhe rezistenca ndaj lëkundjeve sizmike tregojnë një projektim për terrene dinamike. Rezistenca ndaj temperaturave (-25 deri në 55°C) mbulon të gjitha ekstremet klimatike në Shqipëri.

Fashetat Riparuese: Përdorimi i Inoksit dhe gomës me fibra xhami që duron deri në 150°C siguron që riparimet të mos jenë të përkohshme, por afatgjata.

Aspekti Operacional: Mundësia e instalimit nën presion (për fashetat riparuese) është një avantazh teknik kritik, pasi lejon ndërhyrjen pa ndërprerë furnizimin me ujë për konsumatorët.

8.Tuba PVC

Tubat duhet te jene prej polivinil kloridi te paplastifikuar Presioni I punes se tyre duhet te jete minimum 16 bar. Ata duhet te kene rezistence dhe jetegjatesi te larte, ne menyre qe te mos shformohen apo demtohen. Cdo tub duhet te jete I pajisur me manikota te formuara ne skaje dhe te shoqerohen me guarnicione ne menyre qe te mos kete rrjedhje kur te behet bashkimi I tyre.

9.FLLANXHE ADAPTOR

Fllanxhe adaptoret ose koplingjet me fllanxhe ose dhe sic njihen ndryshe fllanxh adaptor universal (taolip etj.) perdoren per te lidhur tubin me rakorderi me fllanxhe, temperatura e punes se ketyre fllanxh adaptoreve duhet te jete 0°C deri ne $+60^{\circ}\text{C}$ (pranohet edhe diapazon me I gjere qe perfshijne diapazonin e kerkuar). Ata duhet te jene te veshur me puder epokside me nje trashesi minimalisht $250\text{ }\mu\text{m}$. Presioni I punes se tyre duhet te jete PN16 ose me I larte. Devijimi kendor I tyre mos te jete me shume se 5° . Bulonat e ketyre koplingjeve me fllanxhe duhet te jene prej materiali celik karboni 8.8 dhe te jene te galvanizuar ne te nxehte. Gjithashtu fundet e tyre duhet domosdoshmerisht te jene te mbrojtur me kapak plastik.

Argumentimi : Mbeshtetur ne nenin 36 te ligjit nr 162/2020 per prokurimin publik
“Specifikimet teknike” kerkohet qe specifikimet te mos hartohen ne menyre qe te favorizojne nje prodhues te caktuar.

Tubat pvc

Rezistenca ndaj Presionit: Kërkesa për një presion minimal prej 16 bar është specifike për tubacionet e transmissiionit që përballojnë goditje hidraulike (goditja e dashit).

- Integriteti Struktural: Pajisja me manikota (prizë) dhe guarnicione në skaje siguron një sistem "push-fit" që garanton hermetizim pa pasur nevojë për ngjitës kimikë, duke ruajtur cilësinë e ujit.

Fllanxhe adaptor

Mbrojtja Antikoroze: Kërkesa për veshje me pudër epokside (250 µm) është jetike. Kjo trashësi shtrese izoluese mbron guri mbron gurin e fllanxhës nga korrozioni galvanik dhe gërryerja e tokës.

Toleranca Gjeometrike: Devijimi këndor deri në 5° lejon fleksibilitet gjatë montimit në terrene jo të rrafshëta, duke shmangur tensionet mekanike që shkaktojnë çarje të tubit. Cilësia e Bulonave: Përdorimi i çelikut karboni 8.8 i galvanizuar në të nxehtë garanton që elementët shtrëngues të mos ndryshken, duke lejuar çmontimin e lehtë pas shumë vitesh për mirëmbajtje.

10.SARAQINESKA BRONXI F

Saraqineskat prej bronxi duhet te jene me leve, te punojne ne presion minimumi 30 bar dhe ne temperature -15°C deri +110°C. Saraqineskat duhet të kenë mbyllje sferike me kalim të integruar dhe hapje pozicionale. Si trupi dhe komponentët e tjetër te saraqineskes duhet te jene prej bronxi. Ne saraqineske duhet te jete e shenuar te dhenat baze si madhesia e saraqineskes, emri I kompanise prodhuese ose ndonje shenje e markes etj. Te jene te certifikuar per perdorim per uji te pijshem.

Permasat e Saraqineskave te kerkuara ne preventive jane:

Saraqineska 2“ ta kete gjatesine minimumi 100mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 35mm, pra minimumi 17.5mm nga secili krah. Leva e saraqineskes te jete minimumi 140mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 110mm.

Saraqineska 1 1/ 2“ ta kete gjatesine minimumi 85mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 33mm, pra 16.5 mm nga secili krah. Leva e saraqineskes te jete minimumi 140mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 100mm.

Saraqineska 1 1/ 4“ ta kete gjatesine minimumi 75mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 31mm, pra 15.5mm nga secili krah. Leva e saraqineskes te jete minimumi 110mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 82mm.

Saraqineska 1“ ta kete gjatesine minimumi 65mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 29mm, pra minimumi 14.5mm nga secili krah. Leva e saraqineskes te jete minimumi 98mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 70mm.

Saraqineska 3/ 4“ ta kete gjatesine minimumi 55mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 25mm, pra minimumi 12.5mm nga secili krah. Leva e saraqineskes te jete minimumi 98mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 64mm.

Saraqineska 1/2“ ta kete gjatesine minimumi 45mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 22mm, pra minimumi 11mm nga secili krah. Leva e saraqineskes te jete minimumi 80mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 51mm.

11.SARAQINESKA BRONXI F

Saraqineskat prej bronxi duhet te jene me leve, te punojne ne presion minimumi 20 bar dhe ne temperature -8°C deri +95°C. Saraqineskat duhet të kenë mbyllje sferike me kalim të integruar dhe hapje pozicionale. Si trupi dhe komponentët e tjeter te saraqineskes duhet te jene prej bronxi. Ne saraqineske duhet te jete e shenuar te dhenat baze si madhesia e saraqineskes, emri I kompanise prodhuese ose I markes etj. Te jene te certifikuara per perdorim per uji te pijshem.

Saraqineska 2 1/2" ta kete gjatesine minimumi 134mm. Gjatesia totale e pjeseve te filetuara te jete minimumi 60mm, pra minimumi 30 nga secili krah. Leva e saraqineskes te jete minimumi 224mm dhe lartesia totale e saraqineskes te jete minimumi 132mm.

